



Radiotelevizioni i Kosovës  
Rr. Xhemajl Prishtina 12,  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
telefon: +381 38 230 119  
tele/Fax: +381 38 235 336

## **BORDI I DREJTORËVE**

# **RAPORT VJETOR PËR VITIN 2007**

**Prishtinë, 2008**

## PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
FJALA E KRYETARES SË BORDIT.....	4
FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM.....	6
MISIONI.....	9
STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	10
TELEVIZIONI.....	11
Shikueshmëria gjatë vitit 2007.....	11
Struktura programore dhe prodhimi.....	12
Programi Informativ.....	13
Programet informative dhe debatuese.....	14
Zgjedhjet 2007.....	14
Dita e zgjedhjeve.....	15
Programi në gjuhët e komuniteteve etnike.....	16
Programi kulturor arsimor dokumentar dhe për fëmijë.....	17
Programi argëtues muzikor sportiv.....	17
Emisionet më të shikuara të Televizionit të Kosovës gjatë vitit 2007.....	18
RADIO KOSOVA.....	19
Programi Informativ.....	19
Emisione e programe të tjera.....	19
Programi në gjuhët e komuniteteve.....	20
RADIO BLUE SKY.....	21
Programi informativ.....	21
Emisione e programe të tjera.....	21
Operativa teknike.....	21
UEB FAQJA RTKLIVE.COM.....	22
SHËRBIMET E PËRBASHKËTA.....	23
Shërbimi i Teknologjisë Informative.....	24
Arsimimi dhe trajnimet.....	25
Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	26
FINANCAT.....	27
Pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2007.....	27
Të hyrat.....	27
Shpenzimet.....	28
Bilanci i suksesit dhe bilanci i gjendjes të RTK-së.....	30

## HYRJE

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është shërbim publik transmetues, që ofron shërbimet e veta në fushën e transmetimit radioteleviziv dhe veprimtari të tjera, sipas Ligjit për RTK-në, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 janar 2006 dhe i ratifikuar nga PSSP më 11 prill 2006.

RTK-ja transmeton në rrjetin terestrial dhe atë satelitor televiziv, me skema të ndryshueshme programore dhe në kuadër të vet ka dhe dy radio stacione, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, si dhe ueb-faqen, [www.rtklive.com](http://www.rtklive.com).

RTK-ja prodhon dhe transmeton program në pesë gjuhë: shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe në gjuhën rome.

Pa marrë parasysh shkallën e shikueshmërisë dhe të dëgjueshmërisë, RTK-ja si shërbim publik ofron program për të gjithë qytetarët.

RTK-ja sot paraqet mozaikun shoqëror dhe etnik të Kosovës i cili inkurajon pluralizmin politik, avancoon diversitetin kulturor, tolerancën ndëretnike, demokratizimin dhe integrimin shoqëror në përgjithësi.

Edhe gjatë vitit 2007, RTK-ja ka bërë hapa të rëndësishëm, si në aspektin programor ashtu dhe në atë zhvillimor, duke ruajtur prestigjin, besueshmërinë, shikueshmërinë e Televizionit dhe dëgjueshmërinë e Radiove. Synimet kryesore të RTK-së për vitin 2007 janë arritur, si ruajtja e pavarësisë editoriale të RTK-së, arritjet në planin e zhvillimit cilësor të programit me përmbajtje tipike për një transmetues publik, të natyrës informative, edukative dhe argëtuese.

Ngjarja që ka shënuar negativisht vitin 2007 për vetë RTK-në është paralajmërimi i shkëputjes së Kontratës për Parapagim, njëanshëm nga KEK-u, më 3 gusht 2007, shkëputje kjo që do të hynte në fuqi më 3 shkurt 2008. Ky paralajmërim nga ana e KEK-ut i është komunikuar RTK-së pak muaj para fillimit të fushatës zgjedhore 2007.

Vendimi i KEK-ut për shkëputje të kontratës, së bashku me akumulimin e borxhit ndaj RTK-së ka ndikuar në hapjen e problemit të qëndrueshmërisë financiare të RTK-së në prag të zgjedhjeve, programit të Vitit të Ri dhe së fundmi shpalljes së pavarësisë.

Radiotelevizioni i Kosovës edhe gjatë vitit 2007 ka rikonfirmuar dhe forcuar rolin e vet të pazëvendësueshëm të transmetuesit të pavarur publik të Kosovës, të respektuar në Kosovë dhe në rajon, si dhe pozicionin e vet kyç në informimin e opinionit kosovar.

## FJALA E KRYETARES SË BORDIT

2007 është vulosur me kërcënimin më të madh për qëndrueshmërinë financiare dhe pavarësinë e Radio Televizionit të Kosovës RTK në historinë e sajë tetëvjeçare: me ndërprerjen e kontratës për mbledhjen e parapagimit nga ana e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Ky vendim i Bordit të KEK-ut, mund të rrezikojë ekzistencën e RTK-së dhe rolin e saj në përmbushjen e mandatit si media e vetme publike e pavarur, i cili ju garanton të drejtën themelore për qasje në informata për të gjithë qytetarët e Kosovës. Duke marrë parasysh se ky vendim u marr në kohë kur zhvilloheshin negociatat për statusin e Kosovës, e beri RTK-në më shumë të ndjeshme për presionet politike si dhe nga grupet e ndryshme të interesit- duke përfshirë edhe UNMIK-un. Mos zgjedhja e bordit të ri, që është dashur të bëhet gati para dy vitesh, ka rritur fragilitetin e RTK-së në këtë situatë.

Cenimi financiar i RTK ka filluar më parë kur nga mbledhësi i parapagimit, KEK-u bëhej transferimi i vonuar i mjeteve të mbledhura në emër të parapagimit. Vonesa të konsiderueshme të bartjes së mjeteve, edhe për disa muaj, e cila është në kundërshtim me kontratën e nënshkruar në vitin 2003, kulmuan me ndërprerjen e parakohshme të kontratës nga ana e KEK-ut, në korrik të vitit 2007. Vendimi, në kohën kur filluan përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, dhe për kuvendet komunale, sfidoj RTK që të përmbushë obligimet e saj sipas mandatit të transmetuesit të vetëm publik në vend. RTK mendon se ky vendim i bordit të KEK-ut është bërë për qëllime politike duke pasur parasysh se dy prej anëtarëve të bordit të KEK-ut, gjegjësisht edhe kryetari i saj, kanë qenë, Ministra të qeverisë aktuale.

RTK i është dhënë gjashtë muaj afat për të gjetur mbledhësin e ri të parapagimit i cili plotëson 80% të të ardhurave të RTK-së. Bordi i RTK, qysh në fillim vlerësoi se ky afat është i pamjaftueshëm dhe do të jetë e pamundur të gjendet zgjidhje e kënaqshme dhe funksionale për mbledhjen e parapagimit. UNMIK-u nëpërmjet Shtyllës së IV insistonte- në kundërshtim me rekomandimet e EBU (European Broadcasting Union) dhe të tjerëve- se KEK-u nuk mund të mbetet mbledhës i parapagimit. Më vonë, Shtylla e IV e UNMIK-ut, urdhëroi KEK-un të vazhdoj mbledhjen e parapagimit edhe për disa muaj, deri në fund të muajit maj 2008. Bisedimet për gjetjen e një solucioni për parapagim janë duke u mbajtur me aktor të ndryshëm, vendor dhe ndërkombëtar, dhe ne besojmë se gjetja e solucionit me të favorshëm se bashkë me ndërrimet në legjislacion relevant do të mundësojnë qëndrueshmëri financiare për RTK për një afat më të gjatë.

UNMIK-u, gjegjësisht shtylla e saj ekonomike ishte gjithashtu mjaft insistuese në presionin ndaj RTK që të implementoj ligjin për buxhet i cili është promulguar nga PSSP-ja. Me këtë ligj, të gjitha fondet e RTK-së, duhet të derdhen dhe të administrohen përmes Thesarit. Bordi i RTK-së, fuqimisht e kundërshton këtë qasje, sepse i jep hapësirë dhe mundësi interesave politike që të ndikojnë në politikat editoriale të RTK, respektivisht të cenojnë pavarësinë editoriale. Bisedimet mes Thesarit me Shtyllën e IV dhe RTK janë duke u zhvilluar për të gjetur mundësi që të ruhet funksionaliteti operacional i RTK-së, duke mos u rrezikuar pavarësia editoriale.

Rëndësi e konsiderueshme në këto zhvillime është edhe implementimi i ngadalshëm i ligjit për RTK-në, nëpërmjet të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendi i Kosovës që të bëj përzgjedhjen e Bordit të ri të RTK-së, për gati dy vjet tani.

Përkundër të gjitha këtyre sfidave dhe presioneve politike, RTK pati sukses që të informoj publikun në mënyre korrekte dhe profesionale, për të gjitha ngjarjet më të rëndësishme në vend, si përcjellja e negociatave për status final të Kosovës, zgjedhjet e nëntorit dhe gjykimet për dyshim për krime të luftës të ish ushtarëve të UCK-se, në Tribunalin e Hagës. Ky sukses vërtetohet edhe me matjen e shikueshmërisë nga organizatat e pavarura profesionale, të cilat edhe në këtë vit e vendos RTK-në, si lider në dëgjueshmëri dhe shikueshmëri në mes të të gjitha medieve elektronike në Kosovë.

Zhvillimi i programeve është bërë në përputhshmëri me politikat programore të Bordit që reflektojnë diversitetin etnik, gjinor, regjional, si dhe demografik të audiencës të cilës i drejtohem. Gjithashtu, kemi patur kujdes që programi të përmbush sa më shumë standardet e transmetuesit publik European, me programe edukative, informative dhe argëtuese, aq sa është e mundur në vetëm një kanal televiziv dhe dy kanale të radiove; Radio Kosovës dhe Radio Blue Sky.

Viti 2008 pritet të jetë vit qenësor për RTK-në. Zgjidhja e mënyrës së financimit të RTK-së që do të mundëson qëndrueshmëri financiare, dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të RTK-së, sipas standardeve evropiane për transmetues publik është e mundshme vetëm me ndërrime të legjislacionit relevant. Këto ndërrime duhet të implementohen nga Bordi i ri i cili duhet të zgjedhjet nga Kuvendi i Kosovës. Shumë e rëndësishme është që themeluesi, Kuvendi i Kosovës të zgjidh edhe çështjen e pronësisë së ndërtesave- hapësirës për punë të RTK-së, ashtu si është e definuar me Ligjin për RTK.

Bordi i tanishëm mbetet i përkushtuar në respektimin e interesave dhe të drejtave të të gjithë qytetarëve, respektimin e ligjit dhe transparencës financiare, si dhe në mbrojtjen e RTK nga influencat nga jashtë. Bordi aktual, gjithashtu inkurajon Bordin e ardhshëm që më tej të zhvilloj këto politika, udhëzime dhe kërkesa nga Kuvendi i Kosovës që të ofroj kornizën e domosdoshme.

Dr. Vjosa Dobruna

## FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Për Radiotelevizionin e Kosovës, viti 2007 ka qenë i rëndësishëm, i suksesshëm dhe dinamik.

Gjatë vitit 2007, RTK-ja ka qenë e fokusuar në mbulimin e procesit të zgjatur, të ndërlikuar dhe delikat të statusit politik të Kosovës. Të gjitha resurset njerëzore, operative, tekniko – teknologjike dhe financiare të RTK-së kanë qenë të angazhuara në shërbim të informimit të saktë, objektiv dhe të shpejtë të qytetarëve të Kosovës si dhe diasporës sonë lidhur me zhvillimet në vend dhe jashtë, e që ndërlidhen me procesin e statusit të Kosovës.

Me këtë rast, i shpreh mirënjohje stafit të Televizionit të Kosovës, Radio Kosovës, Radios Blue Sky dhe ueb-faqes sonë për përkushtim dhe angazhim shembullor, si për raportimin e tyre profesional, ashtu dhe për kontributin e rëndësishëm dhe transparencën e përgjithshme të procesit të pavarësimit të Kosovës. Jam i sigurt se RTK-ja, së bashku me mediat tona të tjera, në vitin e ardhshëm me krenari dhe me përgjegjësi do të raportojnë për përfundimin e suksesshëm të këtij procesi. Siç kemi paralajmëruar, në janar të vitit 2007, nga ana e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të RTK-së, janë nënshkruar një varg dokumentesh, me çfarë, në fakt, ka filluar zbatimi praktik i Reformave të brendshme strukturale dhe ligjore të RTK-së, në frymën e Ligjit për RTK-në, si dhe të standardeve të EBU-se dhe praktikave me të mira evropiane. Në këtë mënyrë, është kompletuar baza normative për zhvillimin e mëtejshëm të RTK-së si një shërbim publik transmetues modern dhe efikas evropian. Veçanërisht i shpreh falënderim Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve të RTK-se për bashkëpunimin dhe kontributin e çmuar dhe konstruktiv në hartimin e Kontratës Kolektive, e cila gjithashtu u nënshkrua në janar të këtij viti dhe paraqet një pjesë përbërëse dhe shumë të rëndësishme të konsolidimit të brendshëm të RTK-se.

Edhe gjatë këtij viti, RTK-ja ka informuar rregullisht lidhur me procesin gjyqësor në Tribunalin e Hagës ndaj ish-eprorëve të UÇK-së, duke e trajtuar si një nga prioritetet programore. Mbulimi i këtij procesi gjatë tërë vitit është bërë me ekipin dhe pajisjet tona në Hagë, përkundër vështirësive evidente të përgjithshme financiare dhe nevojave teknike këtu në Kosovë. Konsideroj se këtë detyrë të rëndësishme e kemi kryer me korrektësi profesionale dhe në pajtim me interesin dhe pritjet e audiencës sonë.

Më 3 gusht 2007, kemi marrë një letër nga KEK-u, në të cilën njoftohet se Bordi i kësaj kompanie publike ka vendosur që të shkëpus kontratën për inkasimin e parapagimit për RTK-në përmes faturave të rrymës, e nënshkruar në nëntor të vitit 2005, me kohëzgjatje të paraparë deri në nëntor të vitit 2008.

Në letër pohohet se kjo kontratë shkëputet njëanshëm për shkak se është vlerësuar se ajo është e dëmshme për KEK-un. Mirëpo, as në letër dhe as me vonë asnjëherë nuk

kemi dëgjuar argumente të bindshme të cilat dëshmojnë se kjo kontratë është vërtet e dëmshme për KEK-un. Ky vendim ka ndodhur vetëm pak me shumë se dy muaj para fillimit të fushatës zgjedhore në Kosovë. Në Bordin e KEK-ut , i cili ka marrë këtë vendim, ishin anëtarë edhe dy ministra të Qeverisë së Kosovës, njëri prej të cilëve ishte edhe kryetar i këtij Bordi. Gjatë vetë fushatës zgjedhore, më 31 tetor 2007, në prononcimin zyrtar para të gjitha mediave, zëdhënësi i Qeverisë deklaroi se Qeveria konsideron se vendimi për shkëputjen e kontratës nga ana KEK-ut duhet të anulohet, por duke e ndërlidhur këtë me nevojën që RTK-ja të ndryshojë politikën e vet editoriale në raport me Qeverinë! Kjo deklaratë është transmetuar po atë mbrëmje në lajmet qendrore të RTK-së. Në vend të komentit, duhet shtuar faktin se lidhur me këtë rast mungoi çfarëdo reagimi publik i institucioneve vendore, partive politike , faktorëve ndërkombëtar, shoqërive dhe asociacioneve profesionale, shoqërisë civile dhe shumicës së mediave, përkundër prononcimit publik të Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të RTK-së.

Përkundër të gjithave, RTK-ja ka demonstruar performancë të shkëlqyeshme në mbulimin e fushatës zgjedhore dhe të vetë zgjedhjeve të vitit 2007. Ndërsa këto ishin zgjedhje të trefishta, që zhvilloheshin paralelisht me procesin e statusit të Kosovës dhe brenda një konteksti më të gjerë dhe shumë të ndjeshëm politik dhe të sigurisë, RTK-ja ia doli që me profesionalizëm, objektivitet dhe dinjitet të mbulojë tërë procesin elektoral në Kosovë. Nuk është e tepërt të thuhet se RTK-ja ka arritur që përmes konceptit të programit zgjedhor në të gjitha gjuhët programore të përqendrojë vëmendjen e elektoratit dhe të opinionit publik në tërësi në problemet konkrete, praktike dhe jetike të qytetarëve, duke involvuar maksimalisht vetë qytetarët dhe duke e përfillur zërin e tyre gjatë aktiviteteve elektorale. Shikueshmëria e lartë e programit zgjedhor, e veçanërisht e debateve të gjalla komunale, ka mundësuar ballafaqimin dhe vetëdijesimin e qytetarit tonë për problemet reale të qeverisjes në shoqërinë tonë, duke i dhënë vullë dhe intonacion fushatës dhe procesit elektoral në përgjithësi. Në kuptimin programor, viti 2007 ka përfunduar me një program të freskët dhe shumë të pëlqyer të Vitit të Ri. Ky program është mbështetur kryesisht në resurset e brendshme profesionale, kreative dhe operativo-teknike të vetë RTK-së, duke dëshmuar potencialin e rëndësishëm të krijuar dhe të kultivuar gjatë këtyre viteve përbrenda kompanisë sonë.

Nga fundi i vitit 2007, televizioni publik gjerman, ZDF, ka njoftuar për vendimin që RTK-së t'i dhurojë njërin nga auto-reportazhet e veta, respektivisht studion mobile televizive. Presim që pranim-dorëzimi i këtij donacioni të rëndësishëm të ndodhë në fillim të vitit 2008. Me këtë rast, ZDF-së i shprehim falënderimin dhe mirënjohjen tonë të sinqertë për këtë donacion të çmuar, si dhe EBU-së për përkrahjen, tashmë tradicionale, edhe në këtë rast.

RTK-ja ndan fatin e proceseve në Kosovë dhe lidhur me Kosovën. Gjatë këtij viti kemi pasur obligime të rëndësishme dhe të shtuara programore që imponohen nga këto procese.

Natyrisht, kjo do të thotë se kemi qenë të ballafaquar edhe me shpenzime të paeftueshme dhe të shtuara për të mbajtur nivelin e performancës sonë programore, për të përmbushur obligimet tona ligjore si shërbim publik transmetues multi-etnik, duke qenë sa më shumë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Mirëpo, pikërisht gjatë këtij viti, operacionet tona kanë qenë shumë të vështirësuar për shkak të vonesave të mëdha dhe të grumbulluara të transferit të mjeteve të inkasuara nga parapagimi nga ana e KEK-ut.

Përkundër kësaj, shikuar në nivelin vjetor, kemi arritur ta ruajmë pozitën e liderit në tregun medial të Kosovës. Madje, presim që vitin 2007 ta përfundojmë me një suficit modest financiar.

Mbetet të shihet se deri kur do të jetë kështu. Ndoshta gjatë vitit 2008 do të kemi përgjigje në këtë pyetje.

Agim Zatriqi

Prishtinë, Janar 2008



## MISIONI

Misioni i RTK-së është që t'i ofrojë auditorit informim objektiv dhe të balancuar, program cilësor edukativ, kulturor dhe argëtues dhe të inkurajojë zhvillim harmonik të demokracisë dhe tolerancës.

Në zbatimin e misionit të vet, RTK-ja ndjek këto parime dhe vlera:

- Lirinë e fjalës, kreativitetit dhe ndërgjegjes,
- Pavarësinë,
- Objektivitetin,
- Korrektësinë,
- Saktësinë,
- Transparencën,
- Respektimin e interesave dhe vlerave të shoqërisë,
- Respektimin e dinjitetit njerëzor, të drejtave individuale, të jetës private,
- Informim të plotë,
- Përgjegjësinë personale,
- Tolerancën,
- Opinionet e ndryshme,

Me shfrytëzimin efektiv të fondeve të veta, RTK-ja mëton të prodhojë program cilësor argëtues dhe arsimor, si dhe lajme objektive, duke iu shmangur propagandimit të çfarëdo lloj dhune, urrejtjeje dhe shkelje të normave të tjera etike.

## **STRUKTURA ORGANIZATIVE**

### **Bordi i Drejtorëve i RTK-së:**

- Vjosa Dobruna /kryetare
- Milazim Krasniqi / anëtar
- Nuhi Rexhepi / anëtar
- Boris Bergant / anëtar
- Snezhana Karaxhiq / anëtare
- Friedhelm Frischenschlager / anëtar
- Uros Lipuscek / anëtar

### **Menaxhmenti i Lartë i RTK-së**

- Drejtori i Përgjithshëm, Agim Zatriqi
- Drejtor i Televizionit, Liridon Cahani
- Drejtor i Radios, Avni Spahiu
- Drejtore e Resurseve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore, Elvana Prekazi
- Drejtor i Financave, Bujar Spahiu

## TELEVIZIONI

Procesi i negociatave për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe Zgjedhjet parlamentare, lokale dhe ato për kryetarë komunash, kanë qenë sfidat kryesore programore të Televizionit të Kosovës gjatë vitit 2007. Që të dy këto projekte të mëdha programore janë realizuar me sukses. Angazhimi i stafit të televizionit gjatë vitit 2007 në këto projekte dhe në projekte të tjera ka qenë në një nivel shumë ta lartë.

Programi Kulturor, Arsimor, Dokumentar dhe për Fëmijë, po ashtu ka shënuar rezultate shumë të mira gjatë vitit 2007.


Programi Argëtues, Muzikor dhe Sportiv, gjatë vitit 2007 veçohet me një program jashtëzakonisht të suksesshëm të Vitit të Ri dhe me rezultate të jashtëzakonshme në shikueshmëri të përgjithshme.

Për të gjitha këto segmente programore më gjerësisht do të flitet në vazhdim të këtij raporti.

### Shikueshmëria gjatë vitit 2007


Një e arritur e jashtëzakonshme gjatë vitit 2007 është ruajtja e vendit të parë në Kosovë për nga shikueshmëria. Ky rezultat është edhe më i rëndësishëm kur kemi parasysh se po përballemi me një konkurrencë të fuqishme, madje edhe joligjore. Fjala është për sistemet kabllorike dhe platformat digjitale tokësore që transmetojnë programe pa të drejta për territorin e Kosovës duke e çrregulluar tërësisht tregun medial në Kosovë. Duhet pasur parasysh se ky rezultat është arritur duke ruajtur fizionominë e transmetuesit publik dhe duke respektuar dispozitat ligjore për transmetim të programit edhe në gjuhët e komuniteteve. Mbi të gjitha, vlen të theksohet se programi informativ, në veçanti Lajmet, kanë shënuar një shikueshmëri shumë të lartë, që është dëshmi e pakontestueshme e kredibilitetit të lartë të Lajmeve të Televizionit të Kosovës tek opinioni publik.

**Në vazhdim do të shihni tabelën e shikueshmërisë së përgjithshme gjatë vitit 2007:**




## Struktura programore dhe prodhimi

Edhe gjatë vitit 2007, Televizioni i Kosovës ka transmetuar programe në harmoni me misionin e vet të transmetuesit publik. Në vazhdim do të shihni një tabelë që pasqyron strukturën programore të Televizionit të Kosovës.



Gjatë vitit 2007 Televizioni i Kosovës ka ruajtur edhe balancën e prodhimeve të veta në krahasim me prodhimet e pavarura, koproduksionet, si dhe programet e huazuara.



## Programi Informativ

Statusi i Kosovës ishte tema që ka dominuar në 5 muajt e parë të vitit 2007, por edhe gjatë tërë këtij viti. Kjo për shkak të paralajmërimeve se statusi do të zgjidhet në muajin maj të këtij viti. Gjatë kësaj periudhe zhvilloheshin edhe bisedimet për statusin midis Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, në këtë kuadër, Këshilli i Sigurimit i OKB-së kishte shumë takime mbi këtë çështje. Të gjitha këto dhe ngjarje të tjera që lidhen me këtë çështje, kanë dominuar në edicionet e lajmeve të televizionit të Kosovës. Vetëm gjatë kësaj periudhe kemi pasur:

- 1) Rreth 100 paraqitje direkte në edicionet e lajmeve:
  - 60% nga qendra të ndryshme evropiane, kryesisht nga Brukseli dhe Vjena për shkak të bisedimeve,
  - 20% nga Nju-Jorku (Këshilli i Sigurimit) dhe Uashingtoni,
  - 20% nga ngjarje të ndryshme nëpër Kosovë, kryesisht nga Prishtina.
- 2) Rreth 800 tema mbi statusin e Kosovës janë realizuar vetëm gjatë vitit 2007.

Kjo shifër tregon se sa rëndësi i është dhënë këtij procesi që, pa dyshim, do të mbetet i shënuar në historinë e Kosovës. Ngjarjet nga bisedimet për statusin e Kosovës janë mbuluar pothuajse 100%. Megjithëse kanë dominuar lajmet nga politika, për shkak të situatës, nuk kanë munguar edhe temat nga përditshmëria (tema sociale, kulturore, infrastrukturore, etj.). Edhe raportimet mbi korrupsionin dhe dukuritë e tjera negative në institucione dhe në shoqërinë kosovare në përgjithësi kanë gjetur hapësirë të mjaftueshme në edicionet e lajmeve të Televizionit të Kosovës. Pas rekrutimit të stafit të ri në sektorin e lajmeve, është shënuar avancim në sektorin e lajmeve ndërkombëtare. Në këtë redaksi është emëruar një redaktor, që ka munguar më parë, gjë që ka shënuar një cilësi shumë më të lartë të përgatitjes së këtyre lajmeve, si dhe një organizim shumë më të mirë. Nga korriku, në edicionin e lajmeve të Televizionit të Kosovës është pranuar edhe një gazetar për të përcjellë vetëm fushën e bujqësisë, e pambuluar deri në atë kohë në edicionet e lajmeve. Deri në fund të vitit 2007, nga sektorët e ndryshëm janë realizuar:

- Mbi 90 tema nga bujqësia,
- Mbi 70 tema sociale,
- Mbi 60 tema nga drejtësia,
- Mbi 40 tema që trajtojnë çështjet e komuniteteve etnike,
- Mbi 50 tema nga kultura (kryesisht nga trashëgimia kulturore),
- Mbi 60 tema nga siguria,
- Rreth 100 tema vetëm mbi mungesën e energjisë elektrike dhe problemeve në KEK,
- Rreth 70 tema për infrastrukturën (uji, ndërtimet, rrugët, kanalizimet, etj.),
- Rreth 40 tema nga shëndetësia,
- Rreth 180 tema politike (problemet partiake, simbolet, përgatitjet për zgjedhjet, etj.).

Fushata zgjedhore është mbuluar nga gazetarët e Dhomës së Lajmeve, të cilët kanë realizuar në mënyrë profesionale raportet nga mbulimi i aktiviteteve partiake. Një raport më të hollësishëm për mbulimin e zgjedhjeve do ta gjeni në vazhdim. Pas zgjedhjeve, kanë dominuar temat për formimin e koalicioneve qeverisëse, por edhe temat për statusin e Kosovës.

## **Programet informative dhe debatuese**

Programet e tjera informative debatuese, po ashtu, janë marrë në mënyrë më analitike me të gjitha temat e lartpërmendura, si dhe me tema të tjera me interes shoqëror.

Emisionet debatuese, në radhë të parë emisioni ‘Jeta në Kosovë’, si dhe ‘Pro et Contra’, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në debatimin e shumë çështjeve të rëndësishme shoqërore dhe kanë ndikuar në masë të madhe edhe në zhvillimin e një debati të gjerë ndëretnik në Kosovë.

Në këtë kuadër, duhet përmendur edhe faktin se janë transmetuar të gjitha seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që kanë qenë me interes për Kosovën, gjykimi në Hagë, si dhe shume transmetime nga ngjarje të tjera të rëndësishme.

Programi i Mëngjesit dhe edicioni ‘Nëpër Kosovë’, ndër të tjera, në masë të madhe kanë mbuluar edhe të gjitha zhvillimet në komunat tona.

Në këtë kontekst, duhet përmendur edhe bashkëpunimi shumë i mirë që ka televizioni i Kosovës me shumë televizione lokale, të cilat me kompensim adekuat, në bazë të marrëveshjeve të nënshkuara, prodhojnë lajme për Televizionin e Kosovës.

Përpyekje janë bërë edhe në paraqitjen e problemeve, aktiviteteve dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me diasporën kosovare. Në këtë kuadër, duhet përmendur edhe emisionet e specializuara për diasporë; ‘Zëri Ynë’ dhe ‘Diaspora’.

Ndërkaq, nga 1 janari 2007, Televizioni i Kosovës mund të përcillet edhe në SHBA dhe Kanada.

## **Zgjedhjet 2007**

Televizioni i Kosovës ka realizuar në tërësi objektivat e veta për një mbulim sa më gjithëpërfshirës dhe profesional të procesit zgjedhor në Kosovë.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e këtyre zgjedhjeve, në të cilat përpos zgjedhjeve parlamentare njëkohësisht janë mbajtur edhe zgjedhjet lokale, si dhe ato për kryetar komunash, konsiderojmë së është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe dhe e suksesshme.

Përpos një programi voluminoz zgjedhor, ka pasur depërtime të reja edhe në cilësinë dhe shumëllojshmërinë e programeve. Kësaj radhe, pos pasqyrimin të rrjedhës së fushatës, janë bërë përpyekje që, përmes analistëve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme, shikuesit tonë t’i ofrojmë mundësi interpretimi profesional të programeve të partive politike, premtimeve që ata bëjnë gjatë fushatës, deklaratave që ata japin, mundësitë reale të implementimit të programeve dhe premtimeve të tyre, e kështu me radhë. Me këtë kemi rritur kështu fokusin në problemet reale dhe të përditshme të qytetarëve nëpër komunat e Kosovës. Duhet theksuar se debatet me kandidatët për kryetarë komunash kanë qenë jashtëzakonisht shumë të shikuara.

Ndërkaq, gjithsesi, një nga risitë e programit zgjedhor ka qenë realizimi i ciklit satirik “Patrolli zgjedhor i dhandrit”, që është pritur shkëlqyeshëm nga audienca.

Ekipi zgjedhor ka realizuar, në një periudhë prej tri javësh:

- 15 debate në gjuhën shqipe për zgjedhjet e përgjithshme,
- 12 debate në gjuhët e komuniteteve për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale,
- 27 debate me kandidatë për kryetar komunash (në bashkëpunim me BIRN),
- 5 debate me analistë (në bashkëpunim me BIRN).

Më pas, çdo ditë është realizuar ‘Kronika zgjedhore’, një termin me kohëzgjatje mesatare prej 25 minutash, si dhe një përmbledhje prej 10-15 minutash, në edicionin

qendror të lajmeve. Po ashtu, ekipi zgjedhor është përkujdesur për transmetimin e spoteve politike pa pagesë.

Duhet theksuar gjithashtu se brenda ditës janë realizuar mesatarisht 18 kronika në gjuhën shqipe, në të cilat ka qenë i angazhuar një ekip prej 6 gazetarësh.

Ndërkaq, kronika të shumta janë realizuar edhe në gjuhët e komuniteteve për edicionet e rregullta të lajmeve në këto gjuhë.

Ndërkaq, përparime janë shënuar edhe në anën vizuale të programit, në radhë të parë në paraqitjen grafike të të dhënave dhe në skenografi.

## **Dita e zgjedhjeve**

Gjatë ditës së zgjedhjeve, Televizioni ka realizuar një program të drejtpërdrejtë gjithëditor, duke filluar nga ora 06:50 e deri në orën 04:30 të ditës së nesërme. Gjatë gjithë ditës kemi tentuar të bëjmë një mbulim sa më të gjerë, duke përfshirë këtu edhe përcjelljen e hapjes së vendvotimeve, daljen në zgjedhje, reagimet nga vendi dhe jashtë, rregullsinë e procesit, situatën e sigurisë, analizën e procesit dhe, më vonë, edhe të rezultateve preliminare. E veçanta e këtij transmetimi është numri jashtëzakonisht i madh i inkuadimeve ‘live’ gjithandej.

Të theksojmë se inkuadime të drejtpërdrejta ka pasur nga Brukseli, Nju-Jorku, Beogradi, Shkupi, Tirana, si dhe nga të gjitha qendrat kryesore të Kosovës: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj. Vetëm brenda një dite, pra më 17 nëntor 2007, janë bërë rreth 45 inkuadime të drejtpërdrejta.

Numri kaq i madh transmetimeve ‘live’, në radhë të parë është mundësuar nga teknologjia e re, e bazuar në sistemin ‘video konferencë’, e blerë enkas për këto zgjedhje.

Janë përcjellë ‘live’ të gjitha konferencat e KQZ-së, si dhe, në mënyrë permanente janë përcjellë edhe rezultatet preliminare (‘Exit polls’) jozyrtare, që i ka dhënë grupi i OJQ-ve “Demokracia në veprim”.

Këto rezultate janë përcjellë me një emision të drejtpërdrejtë në studio me analistë të ftuar, si dhe me shfaqjen e një dokumentari hulumtues mbi lëvizjen e elektoratit nga viti 2004 deri më 2007.

Në fund, të shtojmë se i gjithë ky program është realizuar në mënyrë shumë profesionale dhe tërësisht të balancuar. Ka pasur një numër të vogël ankesash, nga disa subjekte të vogla politike, që të gjitha janë hedhur poshtë nga KPM-ja, si të paarsyeshme.

Gjithsesi, vlen të theksohet se kemi marrë lëvdatë edhe nga EBU-ja, për dërgim të shpejtë dhe cilësor të materialeve në rrjetin e EBU-së

Në bazë të rregullores, në fund të çdo jave i janë dorëzuar KQZ-së raportet e rregullta, me të gjitha të dhënat për hapësirën emetuese në Televizionin e Kosovës, për çdo subjekt politik të certifikuar.

## Programi në gjuhët e komuniteteve etnike

Të gjitha programet në gjuhët e komuniteteve etnike, gjatë vitit 2007, janë transmetuar me rregull dhe kanë shënuar rritje të cilësisë. Duke pasur parasysh se ky vit ka qenë vit zgjedhor, TVK-ja ka realizuar programe të shumta zgjedhore në gjuhët e komuniteteve etnike.

Në këtë kuadër, janë realizuar 12 debate 1 orësh, me kandidatët e komuniteteve etnike që kanë garuar në zgjedhje.


Po ashtu, duhet theksuar se ky program i jashtëzakonshëm nuk është llogaritur në përqindjen e programit në gjuhët e komuniteteve etnike, në programin e tërësishëm të Televizionit të Kosovës.

Vlen të theksohet se edicioni i Lajmeve në gjuhën serbe hyn në mesin e programeve me shikueshmëri të lartë të Televizionit të Kosovës, sidomos pas konsolidimit të terminit të transmetimit në orën 19:00.

Ndërkaq, një ngritje e lartë e shikueshmërisë së programeve, në të gjitha gjuhët e komuniteteve, është shënuar me fillimin e transmetimit të këtyre programeve në rrjetin satelitor, duke i mbuluar kështu edhe ato zona të Kosovës, të cilat akoma nuk janë të mbuluara me sinjal televiziv tokësor.

Në fund, obligimin ligjor për transmetim të programeve në gjuhët e komuniteteve, Televizioni i Kosovës e ka respektuar në tërësi.

**Në vazhdim mund të shihni paraqitjen tabelore:**



Duhet theksuar se në këtë përlllogaritje nuk janë përfshirë reprizat e programit pas mesnatës.



## **Programi kulturor arsimor dokumentar dhe për fëmijë**

Ngritja e vëllimit të programeve të huazuara dokumentare dhe arsimore janë e veçanta e kësaj njësie programore për vitin 2007. Janë hequr nga skema disa emisione të prodhimit vetjak, të cilat për shkaqe objektive (buxhetore) nuk kanë arritur të jenë në harmoni me standardet e Televizionit të Kosovës.

Sidoqoftë, ky program ka realizuar një sërë dokumentarësh mjaft të suksesshëm, si dramat televizive të cilësisë së lartë ('Tensioni i Lartë', 'Vjeshtë e zymtë e profesor Nexhatit'), një serial për fëmijë dhe një cikël dokumentarësh udhëpërshkrues nga metropolet botërore. Që të gjitha këto programe kanë arritur një nivel mjaft të lartë të shikueshmërisë.

## **Programi argëtues muzikor sportiv**

Serialet vendore edhe më tutje kanë vazhduar të thyejnë rekorde të shikueshmërisë dhe kjo, pa asnjë dilemë, është e arritura më e madhe e PAMS-it.

Ndërkaq, kujdes i veçantë edhe më tutje i është kushtuar sigurimit të filmave artistikë dhe serialeve të prodhimit të huaj. Televizioni i Kosovës ka vazhduar të transmetojë disa nga filmat më të mirë të prodhuar viteve të fundit, si dhe disa nga serialet më të popullarizuara botërore.

Në pjesën e dytë të vitit të kaluar, nga skema është larguar edhe një emision me shikueshmëri të lartë, për shkak të pakënaqësisë me nivelin e tij të përgjithshëm, i cili nuk ishte në harmoni me standardet e transmetuesit publik.

'Gala koncerti', tashmë tradicional i BIG Bendit të RTK-së, sivjet i realizuar me rastin e përvjetorit të RTK-së, ka qenë një sukses tjetër i rëndësishëm. Ky koncert tashmë po shndërrohet në një ngjarje të rëndësishme muzikore kosovare.

Ndërkaq, programi i Vitit të Ri, sivjet ka qenë në një nivel shumë më të lartë se vitet e kaluara. Këtë më së miri e dëshmon reagimi i shkëlqyeshëm i auditorit.

Programi sportiv i Televizionit të Kosovës, ka vazhduar të jetë më i miri në Kosovë.

Liga e Kampionëve dhe Liga angleze janë shtyllat kryesore të këtij programi. Rëndësi e veçantë u është kushtuar edhe ngjarjeve sportive kosovare. Janë bërë transmetime të shumë ndeshjeve të kampionatit të Kosovës në futboll dhe janë përcjellë të gjitha aktivitetet e tjera të rëndësishme, vendore e ndërkombëtare. Një kujdes i veçantë u është kushtuar ngjarjeve që kanë pasur të bëjnë me aktivitetet ndërkombëtare të klubeve vendore dhe ndërkombëtarizimin e sportit kosovar në përgjithësi.

## Emisionet më të shikuara të Televizionit të Kosovës gjatë vitit 2007

<b>Titulli</b>	<b>%</b>	<b>Rating</b>	<b>Reach</b>
SERIAL: FAMILJA MODERNE	80.1	770,868	837,112
SERIAL: KAFENEJA JONE	54.53	466,600	594,057
PERRALLE ME TUPAN	54.67	386,801	592,918
LAJMET	49.43	303,657	462,439
SPORT PLUS	42.92	278,780	286,560
FREKUENCA E QUZES	42.53	249,552	393,802
LOTO	35.89	243,194	254,153
UDHËPËRSHKRIMET NGA METROPOLET BOTËRORE	44.47	235,594	312,731
RRUGA PËR EURO 2008- DREJTPËRDREJT	30.83	213,519	213,519
Serial: Spin City	30.57	182,190	254,445
JETA NE KOSOVE	25.17	164,277	310,714
PROGRAMI I MËNGJESIT MIRËMËNGJESI KOSOVË	49.05	144,623	388,978
PROGRAMI I MËNGJESIT MIRËMËNGJESI KOSOVË vikend	37.53	137,623	263,826
LAJMET NE GJUHEN SERBE VESTI	28.51	130,902	152,420
Serial: Friends	24.06	127,788	165,709
PERRALLE ME TUPAN (R) – VAZHDIM	39.55	123,369	143,614
AMAZING BE NJERI	30.02	119,119	213,273
FUTBOLL: SHQIPËRIA-LUKSEMBURGU – DREJTPËRDREJT	21.66	115,445	318,306
MUZIKË POPULLORE	27.28	107,260	116,704
SERIAL PER FEMIJE: "KAQURRELET"	30.49	93,745	144,685
MAGAZINA E LIGES SE KAMPIONEVE	16.94	88,908	134,198
SERIAL : CROSSING JORDAN	21.07	84,310	114,979
TOP RTK- DREJTPËRDREJT	19.69	81,694	154,244

# **RADIO KOSOVA**

## **Programi Informativ**

Gjatë vitit 2007, në Radio Kosovë janë realizuar të gjitha parashikimet programore, sipas skemës programore të RTK-Radios.

Shumë zhvillime në vitin 2007 kanë qenë të lidhura me statusin e Kosovës. Janë përcjellë bisedimet e zhvilluara në Vjenë, Bruksel, Londër, Nju-Jork, takimet e Grupit negociator në Prishtinë, seancat e Kuvendit e të Qeverisë. Një ngjarje mjaft sfiduese mediale – zgjedhjet qendrore dhe lokale nga fundi i vitit, janë përcjellë dhe mbuluar me sukses. Pos përcjelljes së aktiviteteve ditore nga zgjedhjet, në studio të hapur janë mbajtur debate me përfaqësimit të barabartë të subjekteve politike.

Gjatë vitit, gjithashtu, janë përcjellë, herë pas herë, edhe gjykimet në Hagë.

Në vitin 2007, Radio Kosova ka startuar me emisionin e ri informativ INFO 12:00 me të cilin është konsoliduar edhe më shumë programi informativ. Në këtë mënyrë, Radio Kosova iu paraprinë mediave të tjera me informacione më të rëndësishme nga vendi rajoni e bota. Edhe nga dëgjuesit është dëshmuar se INFO 12.00, ka sjellë risi në programin informativ të Radio Kosovës dhe në këtë mënyrë është mirëpritur në opinionin e gjerë.

## **Emisione e programe të tjera**

Në vitin 2007 ka startuar emisioni tashmë mjaft i dëgjuar, ‘Ora gazmore’, me angazhim të autorëve të shquar të humorit tonë dhe në realizim regjisorial dhe aktorial të aktorëve profesionistë të Teatrit Kombëtar. ‘Ora Gazmore’ është konsoliduar mirë dhe ka synim që të bëhet ‘top hit’ i humorit kosovar. Edhe emisioni ‘Meteori’ ka arritur shkallën standarde të programit.

Gjatë vitit, ka vazhduar konsolidimi i programit arsimor shkollor me rubrikat standarde: ‘Për gjuhën tonë’, ‘Nga meridianët’, ‘Juristi ju përgjigjet’, ‘Këshilla mjekësore’, ‘Nga historia e artit’, etj.

Ka vazhduar emisioni për adoleshentë dhe të rinj ‘Hapur’, që transmetohet çdo të shtunë. Ky është një emision që është pritur shumë mirë nga dëgjuesit e rinj me materiale dhe rubrika interesante dhe vazhdon të jetë i tillë. Vashat që përgatisin këtë emision kanë krijuar standardin e tij dhe emisioni ndiqet nga të rinjtë.

Janë transmetuar drejtpërdrejt ‘Koncerti festiv i Vitit të Ri’ nga Vjena, faljet e Bajramit, Krishtlindjet, etj. Gjithashtu janë transmetuar me komentim ndeshjet futbollistike të Kampionatit të Kosovës.

Janë realizuar disa rubrika të reja, në kuadër të programit të mëngjesit. Njëherësh, programi i mëngjesit është përforcuar me staf shtesë. Programi i mëngjesit ka marrë një dimension të ri të trajtimit të temave dhe problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë.

Janë realizuar katër premiera radio-dramatike: një radio komedi dhe tri radio drama, të cilat janë transmetuar në terminet e rregullt në skemën programore të radios.

## **Programi në gjuhët e komuniteteve**

**Programi në gjuhën serbe:** Programi dyorësh në gjuhën serbe, në Blue Sky, ka vazhduar të përmbushë kërkesat programore me sukses për komunitetin serb në Kosovë. Programi që është transmetuar nga ora 14:00 deri më 16:00 ka informuar çdo ditë opinionin serb në Kosovë, me gazetarët në Redaksinë serbe dhe korrespondentët e saj në veri të Mitrovicës, Graçanicë, Gjilan, si dhe nga Beogradi. Edicionet e Lajmeve të Radios në gjuhën serbe janë transmetuar çdo ditë edhe nga Televizioni i Kosovës.

**Programi në gjuhën turke:** Programi në gjuhën turke ka vazhduar të ofrojë informim për komunitetin turk në Kosovë në baza ditore, si dhe emisione muzikore dhe kulturore. Programi në gjuhën turke, shumë i dëgjuar, është transmetuar nga ora 16:00 deri më 18:00.

**Programi në gjuhën boshnjake:** Gjatë vitit 2006, programi në gjuhën boshnjake është transmetuar në dy orë duke filluar çdo ditë nga ora 12:00 deri më 14:00. Në këtë program janë të angazhuar 3 vetë, si dhe katër korrespondentë nga qendra të ndryshme në Kosovë, ku jeton komuniteti boshnjak, si dhe një korrespondent nga Sarajeva.

**Programi në gjuhën rome:** Programi në gjuhën rome në Radio Kosovë është zhvilluar dhe zgjeruar më tej gjatë vitit 2007. Është transmetuar program gjysmëorësh për çdo ditë, duke filluar nga ora 14:00 deri në 14:30. Është angazhuar edhe një gazetare e re në këtë Redaksi, si dhe dy korrespondentë nga mjedise ku jeton komuniteti rom.

## **RADIO BLUE SKY**

### **Programi informativ**

Radio Blue Sky edhe këtë vit ka vazhduar të ruajë identitetin e vet me edicione të shkurtra informative, por koncize dhe të larmishme në transmetim të informacionit. Fokusimi në cilësinë sa më të mirë profesionale të edicioneve të lajmeve vazhdon të jetë një angazhim i përhershëm i stafit të radios. Këtë e mundëson edhe bashkëpunimi dhe organizimi në baza ditore me Radio Kosovën, si medium i të njëjtit transmetues publik, RTK-së. Janë ndërmarrë disa hapa konkretë drejt përmirësimit të përgjithshëm programor informativ. Për të gjitha edicionet e lajmeve: krahas plasimit të lajmeve të fundit dhe sa më të freskëta, janë bërë përpjekje edhe për përditësim sa më të madh. Dy ngjarjet kryesore të vitit, të cilave Radio Blue Sky u ka kushtuar vëmendje të veçantë kanë qenë: bisedimet rreth statusit të ardhshëm të Kosovës, si dhe zgjedhjet lokale dhe parlamentare në vend.

Në vitin 2007, Radio Blue Sky, si gjithnjë, i ka kushtuar vëmendje të veçantë përgatitjes së dokumentarëve të ndryshëm, apo edhe programeve speciale informative, kushtuar dukurive të ndryshme në vend.

### **Emisione e programe të tjera**

Në kuadër të zhvillimit programor gjatë vitit 2007, Blue Sky ka plotësuar skemën e saj me tri emisione të reja, ndërsa shumë prej atyre ekzistuese janë plotësuar me rubrika të reja. Si një zhvillim tjetër i rëndësishëm është transmetimi i koncerteve të mëdha të mbajtura jashtë Kosovës.

Disa nga emisionet shumë të dëgjura në Radio Blue Sky kanë qenë: ‘Jazz Sound’, ‘Blue Top Hiti’, ‘Volt’, (emision tipik foljor nga muaji maj 2007), ‘Metropoli’ (që gjatë muajit korrik është realizuar në Londër dhe në Cyrih e Bernë të Zvicrës, në një prezantim të përgjithshëm të ngjarjeve, shtypit e të jetës në këto qendra), ‘Zëri i arsyes’ (në bashkëpunim të ngushtë me OJQ-në ‘Hendicap Kosova’), etj.

### **Operativa teknike**

Spektori i operativës në RTK-Radio ka realizuar një sërë objektivash të parapara më planin e biznesit për vitin 2007. Ajo ka realizuar një numër të madh transmetimesh nga ngjarje të ndryshme politike, sportive, kulturore dhe religjioze.

Gjatë vitit 2007, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky kanë realizuar mbi 160 transmetime të drejtpërdrejta të ngjarjeve të ndryshme si nga Radio Kosova ashtu dhe nga Radio Blue Sky. Gjatë kësaj periudhe, për nevoja të RTK-Radio janë blerë kompjuterë dhe pajisje të domosdoshme për vazhdimin me sukses të punës, si dhe ka përmirësuar mënyrën e transmetimit të drejtpërdrejtë duke përdorur shpesh edhe auto-transmetuesin.

## UEB FAQJA RTKLIVE.COM

Gjatë vitit 2007, ueb-faqja rtklive.com ka ruajtur parësinë në fushën e informacionit në internet, duke qenë faqja më e vizituar në internet në gjuhën shqipe.

Sipas statistikave tona, por edhe të matjeve neutrale të vizitueshmërisë së përgjithshme të ueb faqeve, rtklive.com gjatë vitit 2007 ka shënuar ngritje të vazhdueshme të vizitueshmërisë, duke arritur deri në 70 mijë vizitorë (IP) në ditë gjatë fushatës zgjedhore.

Ndryshe, mesatarja e vizitueshmërisë në rtklive.com, gjatë gjithë vitit nuk ka rënë nën 40 mijë vizitorë në ditë, e që shënon shumëfishin e vizitueshmërisë së ueb faqeve të tjera në shqip (shih faqen e statistikave, [www.alexa.com](http://www.alexa.com)).

Rtklive.com i është përmbajtur koncepteve themelore- atij të prezantimit të RTK-së në internet por edhe të zhvillimit mediumit të ri të veçantë në kuadër të RTK-së.

Në rtklive.com janë prezantuar produktet kryesore të televizionit të Kosovës ndërkohë që mbeten hapur mundësinë e kyçjes direkte në Radio Kosova dhe Radio Blue Sky përmes faqes sonë.

Lajmet me tekst në Rtklive.com, përveç që vazhdojnë të mbështeten kryesisht në prodhimet e redaksive të RTK-së, kanë shënuar një kalim cilësor, duke vazhduar perfeksionimin e përpunimit të teksteve dhe të titujve për këtë medium specifik, si dhe duke shtuar angazhimin editorial në plasimin e lajmeve relevante nga agjencitë, në mënyrë të mëvetësishme.

Saktësia e lajmeve ka bërë që gjatë vitit të mos kemi raste të demanteve të arsyeshme, pra të publikimit të informacioneve të paqena ose të pasakta.

Shpejtësia e publikimit të informacioneve në rtklive.com, përveç rasteve që kushtëzojnë limitet e justifikuar teknike, është përgjithësisht në nivel të duhur, duke arritur kështu që vizitorëve t'u ofrohen me kohë lajmet më të rëndësishme.

Paanshmëria editoriale, mbështetja në parimin e relevancës dhe prezantimi korrekt dhe i gjithanshëm i ngjarjeve mbesin koncepte themelore editoriale në Rtklive.com.

Koordinimi me mediat e tjera brenda RTK-së ka qenë në një nivel korrekt, sidomos në ballafaqim me ngjarje të rëndësishme, si procesi negociator dhe zgjedhjet e mbajtura, ndërkohë që ky koordinimin mund të zhvillohet edhe më tej në baza të përditshme rutinore.

Përkundër perceptimeve të mundshme, publiku kryesor i rtklive.com nuk është diaspora shqiptare. Mbi 60 % të vizitorëve janë shfrytëzues të internetit nga Kosova, e dhënë kjo që tregon për besueshmërinë e përgjithshme për publikun kosovar, brenda dhe jashtë vendit.

Ndër problemet më serioze të punës sonë paraqesin faqet në gjuhët e minoriteteve.

Përveç faqes në gjuhën turke, në gjuhët e tjera puna akoma lë shumë për t'u dëshiruar, për shkak të probleme të vijueshme. Mbajtja e faqeve në gjuhët e komuniteteve kërkon një rikonceptim të funksionimit dhe mirëmbajtjen se atyre faqeve, ose një angazhim shtesë të redaksive përkatëse.

## SHËRBIMET E PËRBASHKËTA

Viti 2007, për Radiotelevizionin e Kosovës – RTK, si Shërbim Publik i Transmetimeve, shënon pikën kur fillon së zbatuari reforma e përgjithshme organizative dhe ligjore, si rrjedhojë e nevojës së vendosjes së bazës për avancimin e veprimtarisë së saj, përmes strukturës së re organizative.

Puna intensive, e cila ka filluar që nga tetori i vitit 2005, është mbështetur në Ligjin për RTK-në, të miratuar në prill 2006, Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, si dhe standardet dhe praktikat më të mira evropiane, praktika këto të pranuar nga Unioni Evropian i Transmetimeve. Kuptohet se i tërë sistemi komplet i udhëhequr nga praktikat dhe standardet evropiane, është përshtatur me Ligjin e RTK-së dhe me misionin specifik të RTK-së.

Është vendosur një strukturë e re organizative dhe sistem i ri i organizimit të vendeve të punës, përfshirë edhe riorganizimin në formë të rregulloreve të miratuara.

Sistemi, si i tillë, gjatë zbatimit të tij, paraqet bazë për ndryshime, zhvillim dhe avancim, jo vetëm në strukturën organizative, por edhe në sistematizimin e vendeve të punës. Kjo është e mundur të bëhet përmes softuerit specifik, i cili është krijuar për këtë qëllim.

Vendosja e sistemit të pagave, për të gjithë të punësuarit dhe vendosja e metodologjisë së vlerësimit të vendeve të punës, është bërë përmes miratimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të akteve në kuadër të reformës:

1. Katalogu i vendeve të punës me tabelën përkatëse,
2. Rregullorja për organizimin e brendshëm të RTK-së,
3. Rregullorja për autorizime, përgjegjësi dhe kompetenca,
4. Rregullorja për shpërndarjen e parë të të punësuarve,
5. Rregullorja për shpërblime në punë,
6. Metodologjia e vlerësimit të vendeve të punës,
7. Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës,
8. Rregullorja për arsimim,
9. Rregullorja për angazhimin e bashkëpunëtorëve me honorar;
10. Rregullorja për avancimin në punë,
11. Rregullorja për vlerësimin e punës dhe bisedat vjetore,
12. Rregullorja për orarin dhe evidencën në punë.

Në mesin e këtyre akteve, vlen të theksohet se si arritje e veçantë është nënshkrimi i Kontratës Kolektive të RTK-së, e cila është përpiluar në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë midis Menaxhmentit dhe Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve të RTK-së.

Risi e veçantë ka qenë edhe ndryshimi i kohëzgjatjes së kontratave të punësimit për stafin e rregullt të RTK-së, prej një në trevjeçare.

Në vitin 2007, RTK-ja ka filluar punën me gjithsej 409 të punësuar dhe e ka përmbyllur me gjithsej 423 të punësuar të rregullt, me kontrata trevjeçare të punësimit.

Nga ky numër, në Televizion 296, kurse në Radio 127 të punësuar të rregullt.

Ky numër i zvogëluar i të punësuarve të rregullt është paraqitur si rezultat i reformës së përgjithshme në RTK dhe si pasojë e mungesës së buxhetit të planifikuar për vitin 2007, në bazë të të cilit është paraparë zhvillimi i stafit në 442 të punësuar të rregullt.

Brenda vitit 2007 janë lidhur 93 kontrata mbi vepër, për nevojat e sektorëve dhe redaksive të ndryshme programore, në Radio 37 dhe në Televizion 56.

## Shërbimi i Teknologjisë Informative

Shërbimi i teknologjisë informative në RTK, me fillimin e zbatimit të reformës, është ristrukturuar, duke bashkuar njësitë e teknologjisë informative në Radio dhe Televizion. Gjithashtu, njësia e stafit teknik të ueb faqes dhe njësia e zhvillimit aplikativ, i janë bashkëngjitur Shërbimit të Teknologjisë Informative të RTK-së.

Gjatë vitit 2007, zhvillimet në shërbimin e TI-së, janë paraqitur me poshtë:

- Është përgatitur dhoma e serverëve ne RTK-TV për futjen në punë të serverëve të ri. Instalimi dhe futja e plotë e serverëve në punë do te vazhdojë edhe gjatë vitit 2008, ndërrimi i te gjithë SWitch-eve dhe riorganizimi i rrjetit fizik.
- Është realizuar projekti për sjelljen e ‘video stream’ serverëve nga SHBA në zyrën e TI-së, në TV, me anë të një marrëveshjeje mirëkuptimi midis RTK-së dhe ISP Kujtesa.
- Ka përfunduar ndërtimi i sistemit të monitorimit 24-orësh të emisionit tokësor dhe satelitor dhe është futur në funksion. Gjatë vitit, është bërë mirëmbajtja permanente dhe ruajtja e video sinjalit të rakorduar në disqe të jashtme.
- Është realizuar ndërlidhja midis RTK-TV dhe RTK-Radio, përmes një qifti fijesh optike, si pjese e projektit midis RTK-së dhe ISP Kujtesa, ku këmbimi i të dhënave është mundësuar me një shpejtësi më të madhe.
- Është specifikuar në detaje kërkesa e RTK-TV për realizimin e transmetimeve direkte përmes fije optike, e realizuar midis RTK-së dhe ISP IPKO. Është bërë testimi i të gjitha pikave në qytetet e ndryshme dhe janë realizuar 2 transmetime të drejtpërdrejta gjatë zgjedhjeve 2007 në Kosovë, ku shërbimi TI ka realizuar 80% të punës.
- Janë planifikuar dhe ndërtuar dy sisteme të quajtura ‘Character Generator’, të nevojshme për bashkëngjitjen e video-grafikëve në programin televiziv.
- Meqë kompjuterët ne përdorim janë mjaft të vjetër dhe për shkak të kufizimeve buxhetore, nuk është arritur ndërrimi i të gjitha pajisjeve të vjetra. Mesatarisht, llogaritet që 65% e pajisjeve kompjuterike janë të tej-amortizuara.
- Gjatë vitit 2007, shërbimi i TI-së ka filluar ndërtimin e një ‘Intranet’ sistemi, në bazë të kërkesave specifike që ka RTK-ja si medium. Për thjeshtimin dhe automatizimin sa më të madh të punës gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt janë ndërtuar katër module intraneti, si në vijim:
- Skema Programore – modul softuerik për ndërtimin e skemës programore televizive. Arkivon skemat programore të datave të kaluara. Jep mundësi planifikimi të skemave programore të datave të ardhshme. Ky modul mendohet të ndërlidhet në të ardhmen me arkivin e RTK-së për shkëmbim informacioni. Ky modul gjeneron raporte mbi transmetimet, kohën e transmetimit dhe përqindjen në bazë të kriterëve të gjuhës, burimit, origjinës së materialit dhe karakteristikave të tjera.
- Planifikimi i Dhomës së Lajmeve – modul për ndërtimin e planifikimit të punës për arritjen deri tek lajmi. Moduli jep mundësi të planifikimit të punës së gazetarëve dhe ekipit të tij, organizon planet ditore dhe gjeneron raporte mbi punën e gazetarit dhe kameramanit, mbi planet me prioritet të lartë. Arkivon dhe azhuron planet.
- IT Depo – modul, që ndërton bazën e shënimeve mbi pajisjet kompjuterike dhe teknologjike të institucionit. Moduli organizon informacionet mbi çdo pajisje teknologjike të RTK – së, nga momenti i blerjes deri tek konsumi i saj.



- Orari i Punës – modul softuerik për elektronizimin e informatave mbi oraret e punës së punëtorëve, gjenerimin e raporteve mbi punën e tyre, realizuar për kërkesat e TV-Produksionit, ku organizimi dhe oraret, për shkak të natyrës së punës, janë më komplekse, etj.

### **Arsimimi dhe trajnimet**

Në bazë të kërkesave dhe kriterëve, të cilat janë kërkuar me fillimin e zbatimit të reformës së përgjithshme në RTK, në listë të prioriteteve të burimeve njerëzore për vitin 2007, ishte ngritja e nivelit profesional dhe standardeve programore në shërbimin publik transmetues – RTK. Duke pasur parasysh se RTK-ja me vite ka investuar në trajnimin e të punësuarve të vet, për një pune sa më profesionale dhe të ngritjes së cilësisë programore në televizion dhe në radio, është vlerësuar që këta të punësuar të arrijnë shkallën e domosdoshme të kualifikimit të kërkuar me riorganizim. Trajnimet që janë zhvilluar në RTK, gjatë vitit 2007, janë:

- Në kuadër të mbulimit të fushatës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, organizuar nga IREX, trajnimin e kanë vijuar 3 gazetarë të RTK-së,
- 2 gazetarë të RTK-së kanë ndjekur trajnimin “Gazetaria dhe të drejtat e njeriut”, organizuar nga Qendra për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT),
- Trajnimi “Barazia gjinore dhe dhuna në familje”, organizuar nga ATRC- Advocacy Training Resource Center, është vijuar nga një gazetarë e RTK-së,
- Një gazetar i RTK-së ka ndjekur një trajnim intensiv për gazetari hulumtuese në një cikël prej gjashtë muajsh në Sarajevë, organizuar nga Media Qendra e Bosnjë Hercegovinës,
- Nga 2 trajnime të organizuara dhe të financuara nga ERNO (Këmbimi rajonal i lajmeve të Evropës Juglindore) kanë përfituar 2 gazetarë të RTK-së,
- Një rëndësi e posaçme i është kushtuar trajnimit të stafit të departamentit të teknologjisë informative, për shkak të zhvillimeve tekniko-teknologjike në RTK, gjatë vitit 2007.
- Në bazë të marrëveshjes me Akademinë Policore në Vushtrri, për stërvitjen e personelit të sigurimit, gjatë vitit 2007, gjithsej 20 pjesëtarë të personelit të sigurimit në RTK janë certifikuar pranë kësaj Akademie.
- Më 6.11.2007 është mbajtur trajnimi i quajtur "Trajnimi i trajnerëve", organizuar nga Instituti Kosovar i Medias, i cili ka zgjatur 4 javë dhe ka qenë gjithëpërfshirës. Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë që në Kosovë të trajnohen profesionistë, të cilët do të përcjellin njohuritë e tyre tek gjeneratat e reja të gazetarëve. Nga RTK, 6 vetë kanë vijuar këtë trajnim.
- Ndërkaq, më 10 nëntor 2007, RTK-ja edhe zyrtarisht është emëruar anëtare e plotë, me të drejta të barabarta të CIRCOT-it.

## **Marrëdhëniet ndërkombëtare**

Në sektorin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Komunikim me Publikun vlen të theksohet organizimi i të gjitha procedurave të donacionit të ZDF-it për RTK-në të OBVAN-it.

Duhet të theksohet vendosja e kontakteve midis zyrave përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet këtyre zyrave dhe RTK-së, si ato të UNMIK-ut, zyrave të misioneve të huaja në Prishtinë, organizatave joqeveritare dhe qeveritare.

Më 2007 është vazhduar bashkëpunimi me televizionet rajonale dhe koprodukcioni me BBC-në i debatit me titull “Auditorium” si dhe është transmetuar koncert i muzikës klasike me bashkëpunim me Deutsche Welle.

Po ashtu, bashkëpunimi me EBU-në edhe gjatë vitit 2007 ka vazhduar në të gjitha sektorët dhe nivelet. Si deri me tani edhe për vitin 2007 është nënshkruar dhe zbatuar Kontrata për Shërbime EBU-RTK.

## **FINANCAT**

Të hyrat primare të RTK-së në vitin 2007 janë nga parapagimi.

Shpenzimet që RTK-ja ka bërë gjatë vitit 2007 janë më të ulëta se të hyrat që ka realizuar gjatë këtij viti. Shpenzimet në RTK iniciohen dhe realizohen në bazë të procedurave të shkruara, gjë që mundëson kontrollin, arsyeshmërinë dhe mbikëqyrjen permanente të shpenzimeve, të cilat krijohen në RTK gjatë vitit.

Që nga viti 2002, RTK-ja ka themeluar Zyrën e prokurimit, me tre punëtorë profesionalë të punësuar pranë kësaj Zyre, të cilët, në harmoni me rregulloret në fuqi, i mbikëqyrin dhe zbatojnë në mënyrë strikte procedurat e prokurimit.

Që nga viti 2006, RTK-ja ka punësuar Auditorin e Brendshëm, i cili në harmoni me Rregulloret dhe procedurat në fuqi, e bën mbikëqyrjen dhe auditimin e brendshëm të afarizmit të RTK-së.

Nga 1 janari 2006, RTK-ja ka dalë krejtësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, duke u fokusuar në taksën publike, si burim dominant i financimit.

Gjatë vitit 2007, RTK-ja ka ndërmarrë një sërë masash, në drejtim të ngritjes së të hyrave vetjake dhe zvogëlimit maksimal të shpenzimeve, gjë që ka rezultuar që RTK-ja ta përmbyll vitin financiar 2007 me një bilanc pozitiv modest prej 132,132.00 €.

### **Pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2007**


#### **Të hyrat**

Të hyrat kryesore të RTK-së në vitin 2007, kanë qenë nga parapagimi e që përbëjnë afro 81% të të hyrave të përgjithshme të RTK-së. Të hyrat nga marketingu kanë gjeneruar 16% të të hyrave të përgjithshme. Të hyrat nga ri-embursimet kanë gjeneruar 2% të të hyrave të përgjithshme. Të hyrat nga donatorët kanë përbërë më pak se 1% të të hyrave të përgjithshme, ndërsa të gjitha të hyrat e tjera kanë qenë diç më pak se 1% të të hyrave të përgjithshme.

Pagesa me vonesë e mjeteve të inkasuara nga parapagimi, nga ana e KEK-ut, ka qenë problemi kryesor, që e ka ngarkuar RTK-në dhe e ka përcjellë gjatë gjithë vitit 2007. Nga muaji janar 2007 e deri në dhjetor 2007, pagesa e mjeteve të inkasuara nga parapagimi nga ana e KEK-ut është bërë me vonesë prej së paku një muaj e gjysmë ( 45 ditë ) dhe deri më tre muaj e gjysmë ( 109 ditë ).

Borxhet e KEK-ut ndaj RTK-së, në emër të mjeteve të inkasuara nga parapagimi, më 31.12.2007 kapin shumën e përgjithshme prej 2,263,545.13 €.

Në vazhdim, në formë të grafikonit do të paraqesim strukturën e të hyrave të RTK-së gjatë vitit 2007:



## Shpenzimet


RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe synon të ofrojë shërbime që kanë vlerë më të madhe sesa mjetet e shpenzuara.

Kontabiliteti udhëhiqet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në harmoni me Rregulloret përkatëse, që janë në fuqi. Departamenti i Financave i RTK-së, veç raportit vjetor, përpilon edhe raporte financiare tremujore, të cilat rregullisht analizohen dhe shqyrtohen në Menaxhmentin e RTK-së dhe aprovohen nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së. Ekzistojnë politika të shkruara financiare dhe procedura strikte të kontrollit të shpenzimeve. Asnjë shpenzim nuk mund të lejohet dhe paguhet pa aprovimin paraprak me shkrim të së paku dy personave të autorizuar.

Pagesat e pagave të punëtorëve të rregullt, të atyre me kontratë mbi vepër dhe honoraret, bëhen përmes llogarisë bankare, ashtu si dhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve. Pagesat në para të gatshme bëhen vetëm në raste të veçanta dhe të domosdoshme dhe vetëm në shuma të vogla. Pagesat e mëditjeve për udhëtime zyrtare, brenda dhe jashtë vendit, bëhen në bazë të Rregullores së shkruar.

Në fund të çdo viti afarist, RTK-ja formon komisionet për regjistrim (inventarizim) të pasurisë, aseteve, mjeteve të gatshme dhe kërkesave e obligimeve. Komisionet, pas regjistrimit, bëjnë barazimin e gjendjes së konstatuar me regjistrim, me gjendjen në kontabilitet dhe i përpilojnë raportet përkatëse mbi gjendjen e konstatuar. Këto raporte shqyrtohen nga ana e Komisionit Qendror dhe, sipas nevojës, nga ana e Menaxhmentit të RTK-së. Vendimet e marra nga ana e Komisionit Qendror apo/dhe Menaxhmentit domosdoshmërisht zbatohen më tej me regjistrimet përkatëse në evidencën e kontabilitetit të RTK-së.

Në vazhdim, në formë të grafikonit, do të paraqesim strukturën e shpenzimeve të RTK-së për vitin 2007:



**Bilanci i suksesit dhe bilanci i gjendjes të RTK-së  
për vitin 2007**

Bilanci i suksesit të RTK, sipas gjendjes 31 dhjetor 2007

<b>Nr.</b>	<b>TË HYRAT</b>	<b>EURO</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>EURO</b>
1	Të hyrat nga parapagimi	7,991,363	Pagat dhe mëditjet	3,544,783
2	Të hyrat nga marketingu	1,526,519	Programi	2,312,091
3	Rimbursimet	189,098	Amortizimi	909,633
4	Të hyrat tjara	65,668	Investimet	615,677
5	Të hyrat nga donatorët	39,634	Mallra dhe sherbime	604,573
6			Subvencione dhe transfere	583,823
7			Provizioni ndaj KEK-ut	496,401
8			Karburanti dhe mirmbajtja	220,630
9			Shpenzimet komunale	212,369
10			EBU dhe Fidat	146,362
11			Të tjera	33,808
	<b>Total të hyrat</b>	<b>9,812,282</b>	<b>Total shpenzimet</b>	<b>9,680,150</b>

**Total të hyrat      9,812,282€**

**Total shpenzimet    9,680,150€**


---

**Diferenca pozitive    132,132€**

Bilanci i gjendjes të RTK, më 31 dhjetor 2007

Nr.	AKTIVI	EURO	PASIVI	EURO
1	Materiali	1,179,891	Kapitali	7,014,372
2	Kërkesat afatshkurtra	4,700,969	Obligimet afatshkurtra	1,716,006
3	Mjetet fikëse	2,921,940	Suficiti në 2007	132,132
4	Mjetet e gatshme	90,894	Obligimet afatgjate	31,184
<b>Totali i aktivitet</b>		<b>8,893,693</b>	<b>Totali i Pasivit</b>	<b>8,893,693</b>

Aktivi i Bilancit të gjendjes të RTK me 31.12.2007 i shprehur në mënyrë grafike :



Pasivi i Bilancit të gjendjes të RTK me 31.12.2007 i shprehur në mënyrë grafike :

